

Член 13

Со денот на пристапувањето на Република Македонија во Европската унија одредбата од членот 9 на овој закон ќе престане да важи.

Член 14

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR PUNËSIM DHE SIGURIM NË RAST
TË PAPUNËSISË

Neni 1

Në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008 dhe 161/2008), në nenin 1 pas fjalës “persona” vihet presje dhe shtohen fjalët: “persona tjerë që kërkojnë punë”.

Neni 2

Pas nenit 1, shtohen tri nene të reja: 1-a, 1-b dhe 1-v, si vijojnë

"Neni 1-a

Secili ka të drejtë qasjeje në punësim, pa kurrfarë kufizimi në pajtim me parimin për trajtim të barabartë, të përcaktuar në Ligjin për marrëdhënie pune dhe në ligjet tjera.

Në pajtim me parimin për trajtim të barabartë, ndalohet diskriminimi gjatë punësimit në bazë të statusit martesor, statusit familjar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, bindjes politike apo bindjes tjetër, aktivitetit në sindikata, përkatësisë kombëtare, statusit social, invaliditetit, moshës, pronësisë, statusit shoqëror apo statusit tjetër.

Neni 1-b

Qytetarët e Unionit Evropian kanë status të barabartë juridik në marrëdhëniet juridike në pajtim me këtë ligj, si edhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Neni 1-v

Në rast të diskriminimit nga nenet 1-a dhe 1-b të këtij ligji, qytetari ka të drejtë që të kërkojë kompensim për dëmin.

Në rast të kontestit kur është vepruar në kundërshtim me nenet 1-a dhe 1-b nga ky ligj, barra e dëshimit i takon punëdhënësit.

Neni 3

Neni 2, ndryshohet si vijon:

“Nocionet që janë të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijon:

- “punëdhënës” është personi juridik apo njësia e tij organizative e cila e ka selinë në territorin e Republikës së Maqedonisë, apo personi fizik që ka qëndrim të përhershëm në territorin e Republikës së Maqedonisë, të cilët punësojnë punëtorë (në tekstin e mëtejshëm: punëdhënësi),

- “person i vetëpunësuar” është personi fizik që kryen veprimtari të pavarur ekonomike, apo shërbim profesional dhe shërbim tjetër intelektual, nga e cila siguron të hyra në llogari të vet, me kushtet që janë të përcaktuara me ligj,

- “person i papunë” është personi i papunësuar, i paraqitur në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, është i aftë dhe dëshiron që të punojë, nuk ka refuzuar ofertë adekuate për punësim dhe në mënyrë aktive kërkon punë, në pajtim me këtë ligj,

- “punësim adekuat” është punësimi që i merr parasysh gjendjen shëndetësore, kualifikimet dhe aftësitë profesionale të personit, llojin dhe kohëzgjatjen e punës në vendin e mëparshëm të punës, si dhe nevojat, karakterin dhe veçantitë e vendit të ri të punës,

- “Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë” është institucion publik që ofron përkrahje dhe ndihmë, dhe siguron shërbime për pjesëmarrësit në tregun e punës,

- “Agjencia për Ndërmjetësim gjatë Punësimit” është agjenci private për ndërmjetësim për punësim, në vend dhe jashtë vendit me arkëtim,

- “i huaj” është shtetasi i shtetit që nuk është anëtar i Unionit Evropian, shtetit që nuk është palë e Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe Konfederatën Zvicerane,

- “qytetar i Unionit Evropian” është qytetari i vendit anëtar të Unionit Evropian dhe anëtarët e familjes së tyre dhe qytetari i shtetit që është palë kontraktuese e Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe qytetari i Konfederatës Zvicerane dhe anëtarët e familjes së tyre dhe

- “shërbimi për ndërmjetësim gjatë punësimit me arkëtim” është aktivitet i pavarur ekonomik, për të cilin merret kompensim financiar;”.

Neni 4

Në nenin 3 paragrafi 1 pas alinesë 4 shtohet alineja e re 5, si vijon:

“- përgatitja e planit aksional individual për shqyrtimin e aftësisë dhe prirjeve profesionale të personit të papunësuar dhe përcaktimi i llojit dhe shkallës së ndihmës së nevojshme për punësim;”.

Neni 5

Pas nenit 3, shtohet neni i ri 3-a, si vijon:

"Neni 3-a

Për qëllimet e këtij ligji, pjesëmarrës në marrëdhëniet juridike dhe në realizimin e detyrave nga shkëmbimi i punës janë: organet e administratës shtetërore, Agjencia për Punësim e Republikën e Maqedonisë me qendrat për punësim, njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qyteti i Shkupit, punëdhënësit, agjencitë për ndërmjetësimin gjatë punësimit, agjencitë për punësime të përkohshme, personat juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë aktivitete në arsim dhe përgatitje për tregun e punës dhe konsultim profesional, personat e papunësuar dhe personat të cilët kërkojnë punësim, personat e vetëpunësuar, shtetasit e shtetit që nuk është anëtar i Unionit Evropian dhe shtetit që është palë kontraktuese e Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe Konfederatën Zvicerane, shoqata e qytetarëve dhe fondacioneve dhe vendosja e partneritetit për realizimin e projekteve dhe programeve specifike për mbështetje të punësimit, në pajtim me marrëveshjen e posaçme.

Neni 6

Pas nenit 4 shtohet neni i ri 4-a, si vijon:

"Neni 4-a

Agjencia i kryen edhe:
- zhvillimin dhe realizimin e projekteve për përmirësim e tregut të punës, të financuara edhe nga Fondi Social Evropian,

- punët lidhur me punësimin e qytetarëve të vendeve anëtare të Unionit Evropian, në Republikën e Maqedonisë, e tregut për vendet e lira të punës, të cilat mund të plotësohen me shtetas nga vendet tjera anëtare të Unionit Evropian,

- mbajtjen e kontakteve me Zyrën Evropiane për Koordinim,

- ndërmjetësimin gjatë punësimit për qytetarët e Republikës së Maqedonisë, në vendet anëtare të Unionit Evropian,

- dorëzimin e kërkesave, për punësim nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët janë të interesuar që të punësohen në vendet anëtare të Bashkimit Evropian të Zyra Evropiane për koordinim dhe

- punët lidhur me udhëheqjen e evidencës statistikore të të dhënave në lidhje me: fillimin dhe përfundimin e punësimit të qytetarëve të Unionit Evropian dhe anëtarëve të familjeve të tyre; imigrantëve që shpërngulen në territorin e vendit anëtar; emigrantëve që shpërngulen nga territori i vendit anëtar dhe personave që kanë qëndrim të rregullt në vendin anëtar në fund të periudhës referuese."

Neni 7

Në nenin 17 paragrafi 1 alineja 1, pas fjalëve: "presin për punësim" shtohet fjalët: "respektivisht personat që kanë qenë të papunësuar 12 muaj nga 16 muajt paraprak apo gjashtë nga tetë muajt paraprak, për personat më të rinj se 25 vjet".

Neni 8

Në nenin 27 pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, si vijon:

"Agjenci nga paragrafin 1 i këtij neni, mund të themelojë qytetari i vendit anëtar i Unionit Evropian."

Paragrafët 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 bëhen paragrafë 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Neni 9

Pas nenit 44 shtohet nenë i ri 44-a, si vijon:

"Neni 44-a

Agjencia mund të kryejë ndërmjetësim falas gjatë punësimit edhe nga territori i Republikës së Maqedonisë në vendet anëtare të Unionit Evropian, edhe nga territori i vendeve anëtare të Unionit Evropian në territorin e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me ligjet e vendeve anëtare të Unionit Evropian që e rregullojnë lëvizjen e lirë në kuadër të Unionit Evropian."

Neni 10

Në nenin 56 paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

"Personi i papunësuar që e shfrytëzon të drejtën për kompensim me para, është i obliguar që personalisht të paraqitet në Agjenci në çdo 30 ditë dhe të dëshmojë se në mënyrë aktive ka kërkuar punë në muajin e fundit."

Në paragrafin 2 fjalët: "edhe mbrojtje shëndetësore" shlyhen.

Neni 11

Në nenin 58, paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

"Personi i papunësuar është i obliguar që të paraqitet personalisht në Agjenci në çdo 60 ditë dhe të dëshmojë se në mënyrë aktive ka kërkuar punë në muajin e fundit."

Neni 12

Dispozitat nga neni 2 me të cilat shtohet neni i ri 1-b, neni 3, paragrafi 1 alineja 8 dhe neni 7 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga dita e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian, kurse dispozitat nga nenet 6 dhe 9 të këtij ligji do të zbatohen nga 1 janari 2012.

Neni 13

Me ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian, dispozita nga neni 9 i këtij ligji do të shfuqizohet.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

922.

Vrz основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА СПРЕЧУВАЊЕ И ЗАШТИТА ОД ДИСКРИМИНАЦИЈА

Се прогласува Законот за спречување и заштита од дискриминација, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 8 април 2010 година.

Бр. 07-1583/1
8 април 2010 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

ЗАКОН ЗА СПРЕЧУВАЊЕ И ЗАШТИТА ОД ДИСКРИМИНАЦИЈА

I. ОПШТИ ОДРЕДБИ

Предмет на Законот

Член 1

(1) Со овој закон се обезбедува спречување и заштита од дискриминација во остварувањето на правата загарантирани со Уставот на Република Македонија, закон и ратификувани меѓународни договори.

(2) За заштита од дискриминација се формира Комисија за заштита од дискриминација.

(3) Комисијата за заштита од дискриминација има својство на правно лице.

Примена на Законот

Член 2

Заштитата и забраната од дискриминација се однесува на сите физички и правни лица во процесот на остварување на правата и слободите гарантирани со Уставот и со законите на Република Македонија.

Основи за дискриминација

Член 3

Се забранува секоја директна или индиректна дискриминација, повикување и поттикнување на дискриминација и помагање во дискриминаторско постапување врз основа на пол, раса, боја на кожа, род, припадност на маргинализирана група, етничка припадност, јазик, државјанство, социјално потекло, религија или верско уверување, други видови уверувања, образование, политичка припадност, личен или општествен статус, ментална и телесна попреченост, возраст, семејна или брачна состојба, имотен статус, здравствена состојба или која било друга основа која е предвидена со закон или со ратификуван меѓународен договор (во натамошниот текст: дискриминаторска основа).

Примена на Законот

Член 4

Овој закон се применува од страна на сите државни органи, органи на единицата на локалната самоуправа, правни лица со јавни правни овластувања и правни и физички лица во областа на: